

Në bazë të nenit 12, al.2, pika c, nenit 17, pika f, nenit 40 al.2, pika a dhe g, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 al.1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 15 al. 1, pika 8, të Ligjit për Mbeturina, dhe nenit 27 al. 1 dhe 5 të Statutit të Komunës Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shtator 2013, miratoi këtë

## Rregullore

### Mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Prizrenit

#### Neni 1

#### Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, lartësin e tarifës së taksës për MMN, me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar mbi menaxhimin e mbeturinave.

#### Neni 2

**Fushëveprimi:** kjo rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e reciklimit dhe taksën për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor në juridiksionin e Komunës.

#### **Përkufizimet:**

**MMN** – Menaxhimi i Mbeturinave të Ngurta

**Gjenerues i Mbeturinave** – përfshin çdo subjekt, fizik ose juridik, i cili prodhon ose zotëron mbeturina të ngurta.

#### Neni 3

### **Përgjegjësia e Komunës mbi Menaxhimin e Mbeturinave:**

3.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.

- 3.2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
- 3.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
- 3.4. Formimi i sektorit mbi menaxhimin e mbeturinave, në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike:
  - 3.4.1. Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave, monitoron dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave,
  - 3.4.2. Të bëjë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave në Landovicë.
  - 3.4.3. Të identifikoj pikat ilegale ( të zeza) të hudhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.
  - 3.4.4. Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)
  - 3.4.5. Promovimi i ngritjes së vetëdijësimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e MMN-a.
  - 3.4.6. Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
  - 3.4.7. Faturimi i taksës mbi mbeturinat, organizimi dhe shpërndarja.
  - 3.4.8. Përpilimi i raporteve, mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të taksës mbi mbeturinat.
- 3.5. Formimi i komisionit në kuadër të administrates komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive të taksapaguesve për mbeturina.
- 3.6. Taksa për MMN, caktohet nga ana e Kuvendit të Komunës.
- 3.7. Dorzimi i Raportit në Ministrin e Mjedisit dhe planifikimit Hapsinor, për MMN çdo 31 mars të vitit pauses.
- 3.8. Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.

#### **Neni 4**

### **Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave**

- 4.1. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasjeje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,
- 4.2. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë anëkese, ndaj shërbimit të ofruar.
- 4.3. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të rrespektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit të MMN-së.
- 4.4. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundëshme)

4.5. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj taksën e shërbimit.

4.6. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër.

4.7. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat gjenerojn mbeturina, obligohen që komunës së Prizrenit t'ia dorzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat I gjenerojn gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

## **Neni 5**

### **Taksa mbi mbeturinat**

5.1. Taksa mbi mbeturinat, nga janari I vitit 2014, do të faturohet dhe inkasohet nga Komuna.

5.2. Faturimi I taksës së mbeturinave bëhet në baza vjetore, kurse fatura I dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave më së largu deri më 31 mars të vitit kalendarik.

5.3. Gjeneruesi I mbeturinave obligohet të paguaj faturën e taksës së mbeturinave, në katër këste mbrenda vitit, si më poshtë:?

1. Kësti i parë Janar – Mars
2. Kësti i dytë Prill – Qershor
3. Kësti i tretë Korrik- Shtator
4. kësti i katërt Tetor – Dhjetor.

5.4. Pagesa e taksës mbi mbeturinat, në shumën deri në 10 € bëhet në arkën e komunës në Qendër të Shërbimit me Qytetar, kurse në shumën mbi 10 € bëhet në bank.

5.5. Nëse Gjeneruesi i mbeturinave nuk i pagun 2 këste të njëpasnjëshme, nuk do të merr shërbime komunale administrative për:

1. Shërbime Kadastrale,
2. Shërbime nga DUPH
3. Shërbimet nga DSHP
4. Shërbimet nga zyra e Prokurimit.
5. Shërbimet nga DEF.

5.6. Taksa mujore për mbeturina kategorizohet si më poshtë:

Shkalla e taksës do të rishikohet çdo Shtator nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit, etj. Prandaj, kur Kuvendi komunal aprovon shkallën e përshtatshme të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

Prandaj, tarifa fillestare e taksës për mbeturina adapton tarifën e mbeturinave të përdorur në 2013 siç është bashkangjitur në shtojcën 1 (shkalla e taksës për mbeturina).

Prandaj, tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për tu ofrohet institucioneve dhe bizneset e mëdha të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

#### Neni 6

### Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave

6.1. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veproj sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.

#### Neni 7

#### Dispozitat Ndëshkuese - Gjobat

7.1. Gjeneruesit që nuk i përmbahet afateve të pagës së faturave sipas kësaj rregulloreje, ngarkohen me pagimin e dyfishit të vlerës së faturës.

7.2. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bënë pagesën e tarifës së taksës për mbeturina do të inicohet procedur gjyqësore në gjykatën kompetente.

7.3. Gjeneruesi i mbeturinave i cili nuk i përmbahet rregullave të shkarkimit, të përcaktuara sipas planit të MMN-së, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

#### Neni 8

### Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

8.1. Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në Fuqi,

8.2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe njësit përkatëse të administratës komunale.

8.3.Me këtë rregullore të njoftohet, Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

8.4.Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,dhe do të zbatohet nga 1 Janari i vitit 2014.

## **Neni 8**

### **Komisioni këshillues**

8.1 Komisioni këshillues themelohet nën sektorin e menagjimit të mbeturinave-Drejtoria e Shërbimeve Publike, e cila monitoron performancën e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga operatorët e kontraktuar. Ky monitorim do të ndihmonte KeP e cila ka burime njerëzore të kufizuara dhe në të njëjtën kohë do të promovonte sistemin pjesëmarrës të menagjimit të mbeturinave.

8.2 Komisioni këshillues

1. Komisioni këshillues përbëhet nga 10 anëtar ose më pak.
2. Sektori i menagjimit të mbeturinave i rekomandon anëtarët nga kriteret e mëposhtme dhe Kryetari i miraton.
  - (1) Përfaqësues komuniteti
  - (2) Ekspertë Akademik
  - (3) Përfaqësues nga entitetet relevante
  - (4) Qytetarë të zgjedhur mes aplikantëve
3. Detyrat e komisionit këshillues janë:
  - (1) Të monitoroj shërbimin e grumbullimit të mbeturinave ofruar nga operatorët e kontraktuar
  - (2) Të përmbledhin opinionet e qytetarëve sa i përket kualitetit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave
- (3) Të raportoj për rezultatet e monitorimit dhe opinionet e qytetarëve në takimet e komisionit këshillues të cilat duhet të mbahen konform me 9.3.
4. Mandati i anëtarëve të komisionit këshillues është dy vjeçar. Në rast të krijimit të vendit të lirë ,mandati i zëvendësuesit do të ketë validitetin deri ne kohën e mbetur të përfundimit të mandatit të anëtarit paraprak.
5. Anëtari mund të ri-zgjidhet.

6. Pagesa / Meditja e anëtarit është \_\_\_\_ Euro.
- 8.3 Komisioni këshillues duhet të mbajë takime së paku njëherë në tre muaj, përmbledh gjendjen e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave dhe e dorëzon raportin ( Raport 3 mujor) te Sektori për Menagjimin e Mbeturianave.
- 8.4 Sekretaria e Komisionit këshillues është brenda Sektorit të Menagjimit të Mbeturinave dhe Sektori kryen punët administrative.

## Neni 9

### Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare

9.1.Në të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjeve në Fuqi,

9.2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe njësit përkatëse të administratës komunale.

9.3.Me këtë rregullore të njoftohet, Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

9.4.Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,dhe do të zbatohet nga 1 Janari i vitit 2014.

---

#### Shtojca 1: Tarifa e taskës për mbeturina

##### 1. Amvisritë

a) Zona Urbane – 4.50 €

b) Zona Rurale – 4.50 €

1. Tarifa e taksës së mbeturinave do të caktohet në bazë të hapësirës së objektit në m<sup>2</sup>, dhe atë si më poshtë:

a) Bizneset me hapsirë prej 1 - 20 m<sup>2</sup> – 5.20 €

b) Bizneset me hapsirë prej 21 – 50m<sup>2</sup> – 12.15 €

c) Bizneset me hapsirë prej Mbi 50m<sup>2</sup> – 21.50 €

2. Tarifa minimale për Institucionet Publike dhe bizneset e shkallës së lartë të bëhen me kontraktim individual me ofruesin e shërbimit

5.7.1 Kostoja e kontejnerit 1.1m<sup>3</sup> – 11.30 euro/zbrazje

5.7.2 Kostoja e kontejnerit 7m<sup>3</sup> – 44.70 euro /zbrazje